

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Vance: Kush mashtroi taksapaguesit amerikanë gjatë COVID-19, nuk përfiton më kredi qeveritare
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/vance-kush-mashtroitaksapaguesit-amerikane-gjate-covid-19-nuk-perfiton-mekr-i586124
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 19:23:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 19:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	959ff4cbd58be04ac497c3609747ea6d384bb058ead965e1e1ea069e5f06f52b
TEKSTI	155a27288c0c358203275593388b1b573f427dab5501dd583ced939744b21597
PAMJA	95a0b84c90d202c0f4141853613d9ce0439e9b12d8917495c1d8f7c14a3d18d8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	33f9b39e65755b68a9d2ffe4c02f769022695657021530e35eaa041f0519b7de
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	05fd12c73e666390d825ec78dbf996bd3e8990e77e2d97cbe701da17a7d0f007
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/33f9b39e65755b68a9d2ffe4c02f769022695657021530e35eaa041f0519b7de>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



1 e [Nga nje 'like' ne Instagram te propaganda serbe, si u shemb skandali i 'kushteve te keqja' ne Tirane](#) Vuçiq njofton doreheqjen me 27 shtator, hyn ne fushate per zgjedhjet fundit

Vance: Kush mashtroi taksapaguesit amerikanë gjatë COVID-19, nuk përfiton më kredi qeveritare



14 Shtator 2026, 21:40 Bota TEMA



Administrata e presidentit Donald Trump do të pezullojë rreth 870 mijë persona të dyshuar për mashtrim ndaj programeve federale të biznesit të vogël gjatë pandemisë COVID-19, duke i ndaluar ata të përfitojnë nga kreditë e ardhshme të mbështetura nga qeveria.

Zëvendëspresidenti JD Vance deklaroi të hënën se personat që kanë mashtruar taksapaguesit amerikanë nuk duhet të kenë më të drejtë të marrin kredi përmes programeve qeveritare.

"Nëse i keni mashtruar taksapaguesit amerikanë, qeveria federale tani do të thotë se ju është ndërprerë e drejta", u tha Vance gazetarëve, duke shtuar se këta persona nuk duhet të aplikojnë më dhe se aplikimet e tyre nuk do të miratohen.

Njoftimi erdhi në të njëjtën ditë kur Departamenti i Drejtësisë bëri të ditur një seri çështjesh penale në kuadër të një operacioni mbarëkombëtar kundër mashtimit me Programin e Mbrojtjes së Pagave (PPP), të krijuar gjatë pandemisë.

Operacioni, i zhvilluar nga 12 qershori deri më 1 shtator, rezultoi në masa ndaj më shumë se 160 të pandehurve dhe synoi të rikuperojë rreth 245 milionë dollarë humbje të shkaktuara ndaj taksapaguesve.

Hetimi përfshiu prokurorë nga 44 Zyra të Prokurorëve të SHBA-së, si dhe më shumë se 20 partnerë federalë dhe shtetërorë të zbatimit të ligjit.

Autoritetet amerikane kanë intensifikuar ndjekjen e rasteve të mashtimit me fondet e pandemisë, më shumë se pesë vjet pasi qeveria shpërndaui kreditë emergjente për bizneset që u përballën me vështirësi të mëdha ekonomike gjatë krizës së koronavirusit.

 Lini nje Pergjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gjermania urdhëron ushtarët të shërbejnë në Lituani për shkak të mungesës së vullnetarëve](#)

21:00 Bota

Skandal korrupsioni në Ukrainë, Zelensky pezullon prokurorin e përgjithshëm pasi ai largohet nga vendi

20:40 Bota

Rrëzohet avioni në Gjermani, tre të vdekur

20:20 Bota / 1 koment

Vdes në moshën 107-vjeçare i mbijetuari më i vjetër i Holokaustit në Izrael

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.